



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT
BORDI DREJTUES

Nr. 51/prot
16

Tiranë më 26/12/2023

- VENDIM

Nr. 7, datë 26.12.2023

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS SË ZGJEDHJES SË DREJTORIT EKZEKUTIV
DHE AMENDIMIN E RREGULLORES BORDIT**

Në mbështetje të Ligjit nr.10 242 datë 25.02.2010 “Për Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri” neni 11,pika 1 gërma “b”, dhe të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë,” Kreu I, “ Akti Administrativ” Bordi Drejtues :

V E N D O S I

1. Miratimin e procedurës së zgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv.
2. Amendimin e rregullores së Bordit Drejtues duke shtuar procedurën e zgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv.

KRYETARI

Uran BUTKA



RREGULLORE PËR FUNKSIONIMIN E BORDIT DREJTUES TË ISKK¹

NENI I

OBJEKTI

Kjo rregullore ka objekt rregullimin e funksionimit të Bordit Drejtues të ISKK, me qëllim përmbushjen e detyrave që lindin nga Ligji nr. 10 242, datë 25.2.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”

NENI II

BAZA LIGJORE PËR MIRATIMIN E RREGULLORES

Rregullorja është hartuar në zbatim të Ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, Ligjit Nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administrates shtetërore dhe enteve publike” dhe Kodit të Procedurave Administrative.

NENI III

PARIMET E VEPRIMTARISË SË BORDIT

Bordi, gjatë ushtrimit të funksionit dhe kryerjes së detyrave, udhëhiqet nga parimet e:

- a) ligjshmërisë;
- b) barazisë së të drejtave të pjesëmarrësve;
- c) pavarësisë profesionale;
- ç) përgjegjshmërisë në marrjen e vendimeve;
- d) drejtësisë dhe paanësisë; dh) cilësisë dhe efektivitetit;
- e) ruajtjes së konfidencialitetit;
- ë) shmangies së konfliktit të interesave;
- f) integritetit dhe imazhit të ISKK-se.

NENI IV

EMËRIMI I ANËTARVE TË BORDIT DREJTUES.

4.1 Anëtarët e Bordit Drejtues, emërohen dhe lirohen nga Kuvendi.

¹ e azhornuar me:

Vendimin e Bordit nr.7 datë 26.12.2023 “Për miratimin e procedurës së zgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv dhe amendimin e Rregullores së Bordit”.

NENI V

MANDANTI I ANËTARIT TË BORDIT DREJTUES

- 5.1 Mandati i anëtarit të bordit përfundon kur:
- a) mbaron kohëzgjatja e mandatit;
 - b) jep dorëheqjen;
 - c) zgjidhet apo emërohet në funksione, që janë të papajtueshme me mandatin e anëtarit të bordit;
 - ç) deklarohet i paafte për të vepruar, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - d) dënohet, me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një krimi;
 - dh) vërehen akte e sjellje, që cenojnë rëndë figurën e anëtarit të bordit;
 - e) vdes.
- 5.2 Kuvendi liron nga detyra një anëtar bordi kur vërtetohet se:
- a) ka dhënë informacion të pavërtetë për përmbushjen e kriterëve që parashikon pika 2 e nenit 8 të këtij ligji;
 - b) nuk merr pjesë në veprimtarinë e bordit për një periudhë mbi 6 muaj, përjashtuar rastet e mungesës për arsye shëndetësore.

NENI VI

ZGJEDHJA E DREJTUESVE TË BORDIT

- 6.1 Pas konstituimit të Bordit, në mbledhjen e tij të parë, Bordi zgjedh, me shumicën e votave të anëtarëve, kryetarin dhe nënkryetarin e tij.
- 6.2 Nënkryetari i Bordit ushtron detyrat e kryetarit në mungesë të tij.

NENI VII

KOMPETENCAT DHE DETYRAT E KRYETARIT

- 7.1 Kryetari i Bordit Drejtues ka këto detyra:
- a) Në bashkëpunim me Drejtorin e Institucionit cakton datën dhe vendin e mbledhjes së Bordit drejtues.
 - b) Në bashkëpunim me Drejtorin e Institucionit vendos rendin e ditës së çdo mbledhje.
 - c) Ngarkon sekretaren e Bordit për përgatitjen e materialeve sipas rendit të ditës për çdo mbledhje.
 - d) Kryetari është i detyruar të therrasë një mbledhje edhe kur kjo kërkohet me shkrim nga të paktën 1/3 e anëtarëve me të drejte vote, duke përcaktuar çeshtjet për të cilat thirret kjo mbledhje.

e) Kryetari mund të shtyjë ose të mbyllë mbledhjen përpara kohe, në rastet kur situata e përlikj këtë veprim. Në këto raste duhet të merret një vendim i arsyetuar, i cili do të pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes.

NENI VIII

TË DREJTAT DHE DETYRAT E ANËTARËVE TË BORDIT DREJTUES

8.1 Anëtarët e Bordit Drejtues janë të pavaruar në vendimarrje dhe bazohen vetëm në kompetencat e legjislacionit ne fuqi, (neni 11 i ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010) si dhe në respektimin e drejtë dhe të panshëm të interesave të përfshira; funksionon sipas parimit të barazisë së anëtarëve.

8.2 Të drejtat dhe detyrat janë:

- a) Merr vendime me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe kanë të drejtën e votes, përveç rasteve kur me ligj kërkohet një shumicë e cilësuar.
- b) Merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes, përveç rasteve kur të pakten 2/3 e anetareve vendosin për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për çështje që nuk janë në rendin e ditës.
- c) Njihen, studiojnë materialet e mbledhjes dhe kërkojnë sqarime të nevojshme nga strukturat e institucionit dhe kur është nevoja nga Këshilli Shkencor. Shqyrtimi I dokumentacionit bëhet duke rrahur mendimet në rrugë kolegjiale dhe nën suportin e Drejtorit të Institucionit.
- d) Cdo anëtar duhet të njoftojë për mospjesëmarrje në mbledhje.
- e) Votoje për çështjet që shqyrtohen. Vendimi kundra pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes.

NENI IX

DETYRAT E SEKRETARES SË BORDIT DREJTUES

9.1 Sekretarja e Bordit Drejtues zgjidhet nga Bordi Drejtues, i/e cila mund të jetë punonjës i institucionit.

9.2 Sekretarja ka këto detyra:

- a) Të shtyp (të zbardhë) vendimet e marra në mbledhjen e Bordit Drejtues.
- b) Të njoftojë anëtarët e Bordit për pjesëmarrje në mbledhje.
- c) Të dërgojë materialet e përgatitura sipas rendit të ditës, nga drejtoritë përkatëse të institucionit, pranë anëtarëve të bordit drejtues, jo më vonë se 5 ditë nga dita e zhvillimit të mbledhjes.
- d) Në cdo mbledhje mbahet një procesverbal ku bëhet një përmbledhje e gjithçkaje që thuhet në mbledhje, data, vendi, anëtarët që moren pjesë

- çështjet që diskutuan vendimet që u morën si dhe rezultati i votimeve.
- e) Procesverbali mbahet nga sekretari/ja dhe duhet t'u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse.
 - f) Nëse mbledhja zhvillohet *online*, procesverbali i mbledhjes duhet t'u bëhet me dijë të gjithë anëtarëve të mbledhjes nëpërmjet e-mailit.
 - g) Para zhvillimit të çdo mbledhje pasardhëse të Bordit Drejtues, duhet të bëhet i ditur vendimi i marrë nga kryetari i bordit në mbledhjen paraardhëse.
 - h) Të plotësojë dosjen për vendimet e marra të Bordit Drejtues, në të përfshihen njoftimi për mbledhje, rendi i ditës, procesverbali i nënshkruar nga anëtarët e Bordit dhe vendimet prej tij.

NENI X

PROCEDURA E ZHVILLIMI TË MBLEDHJES

- 10.1 Mbledhja e Bordit është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Kur nuk janë të pranishëm shumica e anëtarëve, kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër, të paktën 24 orë pas së parës.
- 10.2 Lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve bëhen brenda 15 ditëve pas paraqitjes së kërkesës për mbledhje, të paktën 48 orë para datës së thirrjes të mbledhjes.
- 10.3 Lajmërimi për thirrjen e një mbledhjeje duhet të tregojë në mënyrë të qartë dhe të detajuar çështjet për të cilat do të diskutohet.
- 10.4 Vendimet e bordit drejtues merren me votim të hapur dhe me shumicën e numrit të anëtarëve.
- 10.5 Në rast se votimi bëhet i fshehtë dhe votat janë të barabarta, do kryhet një votim i dytë. Kur edhe në votimin e dytë ka barazi të votave, vendimi do të shtyhet për mbledhjen tjetër. Në qofte se në votimin e parë të mbledhjes tjetër do të kemi përseri një barazi votash, atëherë do të kryhet votim i hapur, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2 të nenit 13.
- 10.6 Nuk lejohet abstenim gjatë votimit.
- 10.7 Nuk lejohet gjatë zhvillimit të mbledhjes të hyjnë dhe të qëndrojnë persona të cilët nuk janë pjesë përbërëse e Bordit. Vetëm në raste, kur çështjet lidhen me ta, dhe në këtë rast duhet të miratohet me shumicë votash nga Bordi Drejtues.

NENI XI

DHËNIA E VENIDMIT

- 11.1. Pasi të jetë shqyrtuar i gjithë dokumentacioni, Bordi Drejtues diskuton çështjet dhe i shtron për votim. Anëtarët e Bordit votojnë në mënyrë individuale.
- 11.2. Vendimi i Bordit Drejtues duhet të përmbajë:
 - a) Bazën ligjore.
 - b) Kohën dhe vëndin e dhëniës së vendimit.
 - c) Objektin dhe lëndën.
 - ç) Mënyrën e votimit.



- d) Rezultatit e votimit duke u shprehur “unanimisht” ose me shumicë votash.
e) Duhet të nënshkruhet nga kryetari ose nga të gjithë anëtarët e Bordit Drejtues.

NENI XII¹

PROCEDURA E ZGJEDHJES SË

DREJTORIT EKZEKUTIV

1. Njësia përgjegjëse (BNJ) në ISKK njofton Bordin Drejtues për përfundimin e mandatit të Drejtorit Ekzekutiv, 60 ditë para përfundimit të mandatit.
2. Zgjedhja e Drejtorit Ekzekutiv bëhet në disa faza, të cilat ndiqen sipas renditjes në këtë Rregullore.
3. Faza e parë konsiston në këto veprime:
 - a. Shpallja e procedurës së konkurrimit dhe të gjithë hapat e tjerë bëhen në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të ISKK, dhe në ambientet e brendshme të ISKK, të paktën 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara datës të parashikuar për zhvillimin e konkurrimit.
 - b. Shpallja mbahet në portal, faqen e internetit dhe në ambientet e brendshme të ISKK për të gjithë kohën deri në shpalljen e fituesit.
 - c. Shpallja e përmendur më sipër përmban, të paktën, këto të dhëna:
 - i. pozicionin e punës për të cilin zhvillohet konkurrimi;
 - ii. përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës;
 - iii. kriteret e përgjithshme;
 - iv. kërkesat specifike të pranimit;
 - v. dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes të kandidaturave;
 - vi. mënyrën e shqyrtimit dhe shpalljen e rezultateve të seleksionimit paraprak;
 - vii. datën për paraqitjen e aplikimit;
 - viii. datën e zhvillimit të konkurrimit;
 - ix. datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak;
 - x. datën për shpalljen e rezultateve për vlerësimin përfundimtar;
 - xi. mënyrën e vlerësimit, njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar;
 - xii. mënyrën e njoftimit/komunikimit me aplikantët.
 - d. Aplikimi për konkursin kombëtar duhet të paraqitet brenda një periudhe të paktën 30-ditore nga shpallja për zhvillimin e konkurrimit.
 - e. Kandidatët duhet të paraqesin pranë institucionit të pavarur dokumentacionin, sipas kërkesave të përcaktuara në shpallje.

¹ i azhornuar me:

Vendimin e Bordit nr.7 datë 26.12.2023 “Për miratimin e procedurës së zgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv dhe amendimin e Rregullores së Bordit”.



- f. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit, njësia përgjegjëse e institucionit të pavarur bën verifikimin paraprak të dosjeve të kandidatëve nëse plotësojnë kriteret specifike. Në përfundim të këtij afati, njësia përgjegjëse shpall në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare në internet dhe në ambientet e institucionit listën e aplikuesve që plotësojnë kriteret specifike, për t’iu nënshtruar konkursit, duke i renditur ata sipas rendit alfabetik.
 - g. Kandidatët që nuk janë shpallur të kualifikuar njoftohen nga njësia përgjegjëse dhe kanë të drejtë të paraqiten pranë saj, për t’u njohur me arsyet e moskualifikimit. Ata mund të ankohen brenda 5 (pesë) ditëve pune nga shpallja e listës pranë njësisë përgjegjëse. Njësia përgjegjëse duhet të kthejë përgjigje të arsyetuar brenda 2 (dy) ditëve pune e, kur është rasti, bën korrigjimin e listës dhe merr masa për publikimin e listës së korrigjuar.
4. Faza e dytë konsiston në këto veprime:
- a. Me përfundimin e shqyrtimit të ankesave, njësia përgjegjëse i përcjell Bordit Drejtues të ISKK listën e kandidatëve që do t’i nënshtrohen procedurës së konkurrimit.
 - b. Njoftimet për procedurën e pranimit, që nga momenti i shpalljes së procedurës e deri në shpalljen e fituesit, bëhen në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, faqen zyrtare në internet të ISKK dhe në ambientet e përcaktuara nga ISKK.
 - c. Bordi Drejtues i ISKK ndjek, më pas, procedurën e përcaktuar në pikat 4-19 të kreut IV të VKM Nr 118 datë 05.03.2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”.
5. Bordi cakton ditën e marrjes së kandidatëve në intervistë.
6. Zhvillohet votimi. Procedura e votimit nga Bordi për zgjedhjen e Drejtorit Ekzekutiv zhvillohet si më poshtë:
- a. Bordi organizon sekretari teknike.
 - b. Votimi bëhet i fshehtë.
 - c. Zgjedhja e drejtorit ekzekutiv bëhet me pjesëmarrjen fizike të të gjithë anëtarëve të Bordit.
 - d. Krijohet një komision i brendshëm me anëtarë të Bordit
 - e. Komisioni përgatit fletën e votimit dhe kutinë e votimit.
 - f. Komisioni numëron votat dhe shpall rezultatin.
 - g. Procedura e zgjedhjes së drejtorit ekzekutiv pasqyrohet në proceverbal, përfshi përbërjen e komisionit, mënyrën e votimit, përgatitjen e materiale, shpalljen e rezultateve.
7. Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për DE janë të përgjithshme dhe të posaçme. Kriteret e përgjithshme përcaktohen sipas ligjit 152/2013 të nënpunësit civil.

8. Kandidati për Drejtor Ekzekutiv duhet të plotësojë disa kritere të posaçme që konsistojnë në këto cilësi:
- a) Aftësi për të drejtuar dhe menaxhuar veprimet e ndryshme (minimumi 10 vite punë, preferohet eksperiencia në pozicione drejtuese).
 - b) Niveli diplomes master shkencor, fusha e studimit: shkenca shoqërore dhe juridike.
 - c) Kandidati duhet të paraqesë një platformë apo vizion për drejtimin e ISKK.
 - d) Aftësi komunikimi;
 - e) Aftësi të drejtimit strategjik;
 - f) Ndërtim i marrëdhënieve ndërpersonale;
 - g) Efektivitet;
 - h) Aftësi pune në grup;
 - i) Kuptim të gjerë të kompetencave ndërsektoriale;
 - j) Njohuri mbi fenomenet sociale dhe ekonomike të historisë së komunizmit: artikuj shkencorë, monografi, etj;
 - k) Besueshmëri;
 - l) Vizion;
 - m) Të qenët krijues;
 - n) Integritet;
 - o) Njohuri për sistemin ligjor evropian për çështjet e komunizmit.
 - p) Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze.
 - q) Të plotësojë kriteret e veçanta sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 18 të ligjit të ISKK.
9. Procedura e pranimit organizohet nga njësia përgjegjëse e ISKK dhe është e organizuar në dy faza, në fazën pranuese dhe seleksionuese.

NENI XIII

DISPOZITA E FUNDIT

- 12.1 Rregullorja do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi.
- 12.2 Çdo ndryshim i rregullores kërkohet me shkrim nga të paktën dy anëtar të Bordit dhe ndryshimet sëbashku me relacionin prezantohen jo më vonë se një muaj për votim dhe Bordi vendos me shumicë të thjeshtë.
- 12.3 Ndryshimi i rregullores do të bëhet me shkrim në të kundërt është i pavlefshëm.
- 13.4 Ngarkohet për zbatim Bordi Drejtues i Institucionit dhe ISKK.
- 13.5 Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT

URAN BUTKA

